

Bachelor në “Ekonomiks i Aplikuar”

(180 ECTC, 3 vite akademike, me kohë të plotë)

Profili profesional (PËRSHKRIMI I DEGËS)

Ky program studimi është hartuar për të përgatitur profesionistë të fushës së vendimmarrjes, menaxherë dhe studiues në fushën e ekonomisë, me fokus zhvillimin bujqësor. Programi synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh si: menaxher financiar, ekonometricien/statisticien, analist tregu, analist biznesi, ekonomist agrar, ekonomist i mjedisit dhe burimeve natyrore, ekonomist në njësitë e qeverisjes lokale, si dhe gazetari ekonomike, mësimdhënie, asistencë në aktivitete kërkimore shkencore, marrëdhënie ndërkombëtare, specialist në projekte zhvillimore, konsulencë etj.

Modulet e këtij programi japin njohuri të përparuar në fusha studimi apo punësimi ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës si dhe për sektorin e punësimit publik dhe privat duke aplikuar instrumenta sasiore dhe cilësore të fushave të ekonomisë, menaxhimit, financës, kontabilitetit, ndërthurur me njohuritë rreth bujqësisë e zhvillimit rural.

Një nga objektivat kryesore formuese të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Ekonomiks i Aplikuar" është përgatitja e profesionistëve në fushën e ekonomisë dhe analizës ekonomike, nevojë kjo e çdo sektori publik apo privat. Gjithashtu ky program synon të formojë specialistë me njohuritë me bashkëkohore në fushën e kërkimit, me qëllim mundësimin e një kualifikimi më të avancur shkencor për nivelet e tjera të studimit në financë e menaxhim apo edhe në fusha me karakter të veçantë si ekonomiks bujqësor, zhvillim rural i integruar dhe menaxhim mjedisor i turizmit. Programi "Ekonomiks i Aplikuar" ka objektiv të përgatisë studentët me njohuri ekonomike në fusha të tilla si: mikroekonomi, makroekonomi, statistikë etj. duke përgatitur specialistë të përgjithshëm të ekonomisë, të aftë për tu përballuar me problematika të matjes, vlerësimit, monitorimit të performancës ekonomike si dhe të hartimit të zgjidhjeve të aplikueshme në fushën e ekonomisë. Specifikat e këtij programi konsistojnë në faktin që ai u siguron studentëve kompetenca për aplikimin e ekonomiksit në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural dhe mjedisit.

Modulet kryesore të trajtuara përgjatë studimeve të këtij programi të kategorizuara sipas tipologjisë:

a. Lëndë bazë

1. Matematikë
2. Mikroekonomi I
3. Makroekonomi I
4. Statistikë
5. Bazat e Ekonometrisë

b. Lëndë karakterizuese

1. Matematikë Ekonomike
2. Statistike Biznesi
3. Ekonomiksi Publik
4. Hyrje në Ekonomine e Prodhimit Bujqësor
5. Hyrje në Ekonomine Bujqësore
6. Ekonomia e Burimeve Natyrore & Mjedisit
7. Ekonomiks Nderkombëtar
8. Zhvillimi Rural i Qëndrueshëm
9. Mikroekonomi II
10. Makroekonomi II

11. Mikroekonomi III
12. Ekonomiksi i Punes
13. Ekonomiksi i Drejtimit
14. Kontabilitet
15. Bazat e të Drejtës
16. Financë
17. Marketing

c. Lëndë ndërdisiplinore/ integruese.

1. Prodhim Bimor
2. Prodhim Shtazor
3. Sociologji
4. Historia e Doktrinave
5. *Drejtimit i Fermave / Tregje dhe Institucione Financiare*
6. *Menaxhim Karriere / Demografi / Njohuri mbi Informacionin*

d. Lëndë plotësuese

1. Praktike profesionale
2. Gjuhë e huaj 1+2
3. Informatikë

e. Detyrimet përmbyllëse

1. Teza Bachelor

Ky program formon specialistë të ekonomisë që mund të punojnë në:

- Administratën publike lokale,
- Insitucionet publike të varësisë dhe kompanitë private dhe ferma,
- Në njësi të shoqërisë civile që kërkojnë dije e metoda të aplikuara në fushën e ekonomisë bujqësore, zhvillimit rural e menaxhimit mjedisor,
- Institucione të ndryshme të sektorit bankar dhe të sigurimeve,
- Institucione të shërbimeve të këshillimit,
- Institucionet e sigurimeve dhe kreditimit bujqësor.

PROGRAMI MËSIMOR

Viti, Sem	Nr	Modulet	Kredite	
Viti I, Semestri I (1)	1	Prodhim Bimor	4	
	2	Mikroekonomi I	6	
	3	Sociologji	4	
	4	Matematikë	7	
	5	Gjuhë e huaj	3	
	6	Bazat e të Drejtës	5	
Viti I, Semestri II (2)	1	Prodhim Shtazor	4	
	2	Matem Ekonomike	6	
	3	Statistikë	6	
	4	Mikroekonomi II	6	
	5	Gjuhë e Huaj	3	
	6	Makroekonomi I	6	
Viti II, Semestri I (3)	1	Statistike Biznesi	6	
	2	Kontabilitet	5	
	3	Hyrje ne Ekonomine e Prodhimit Bujqesor	5	
	4	Ekonomiks Nderkombetar	5	
	5	Financë	5	
	6	Ekonomia e Burimeve Natyrore & Mjedisit	5	
Viti II, Semestri II (4)	1	Informatikë	4	
	2	Hyrje në Ekonomine Bujqësore	5	
	3	Mikroekonomi III	5	
	4	Makroekonomi II	5	
	5	Marketing	5	
	Modul me Zgjedhje 1			
	6	<i>Drejtimit i Fermave</i>		5
<i>Tregje dhe Institucione Financiare</i>				
Viti III, Semestri I (5)	1	Bazat e Ekonometrisë	6	
	2	Ekonomiksi Publik	5	
	3	Ekonomiksi i Drejtimit	5	
	4	Zhvillimi Rural i Qëndrueshëm	5	
	Modul me Zgjedhje 2			
	5	<i>Ekonomiksi Institucional</i>		5
<i>Analizë financiare</i>				

		<i>Paraja dhe Bankat</i>		
Viti III, Semestri II (6)	1	Historia e Doktrinave	4	
	2	Ekonomiksi i Punes	5	
	Modul me Zgjedhje 3			
	3	<i>Menaxhim Karriere</i>		4
		<i>Demografi</i>		
		<i>Njohuri mbi Informacionin</i>		
4	Praktike profesionale		12	
5	Teza Bachelor		9	
Totali i Krediteve		1+2+3+4+5+6	180	